



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve



Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: [+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
[ëëë.avokatipopullit.gov.al](http://eëë.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2024
Nr. Dok. 202400553/2

Lënda: Rekomandim për ndryshimin e strukturës akomoduese të shkollës speciale “Zëra Jete” në Elbasan dhe përmirësimin e trajtimit të fëmijëve në këtë institucion

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

**AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

TIRANË

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

BASHKISË ELBASAN

SHKOLLËS SPECIALE “ZËRA JETE”

ELBASAN

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të Kushtetutës dhe ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, realizoi inspektimin në Shkollën Speciale “Zëra Jete”, Elbasan, duke evidentuar problematikat dhe adresuar rekomandimet përkatëse për përmirësimin e

veprimeve të organeve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor në interesin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Legjislacioni për arsimin e fëmijëve me AK

E drejta për arsimim është një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila duhet të gëzohet në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë nga të gjithë. Kushtetuta e RSH-së në nenet 57 dhe 59 të saj garanton të drejtën për arsim për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë pa dallim. Në këtë kontekst, fëmijë me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejtën për t'u arsimuar sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar¹. Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr.69/2012), në nenin 5 përcakton se “1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, **aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar**”. Me ndryshimet e fundit që i janë bërë ligjit nr.69/2012², në nenin 64/1 janë dhënë këto përcaktime lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në qendra burimore: “1. *Qendër Burimore është institucioni i arsimit special, që ka për qëllim të mbështesë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar në vijimësi rezultatet e të nxënit dhe t'i përgatisë ata për gjithëpërfshirjen dhe aftësimin për jetën, duke zhvilluar aftësitë e duhura në të gjitha fushat e përditshmërisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi për aksesueshmërinë dhe mosdiskriminimin.*”

Po kështu, në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026³ parashikohen ndër të tjera, si objektiva edhe:

“A1.3.3. Fuqizimi i shkollave speciale dhe kthimi i tyre në qendra burimore për aftësinë e kufizuar. Duhet zhvilluar role të reja për shkollat speciale duke i konvertuar ato në qendra burimore me një diapazon të gjerë funksionesh në dobi të mbështetjes së arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në ato rajone ku mungojnë shkollat speciale, do të caktohen, fillimisht në formë pilotimi, shkollat që duhet të funksionojnë si qendra

¹ Komenti i Përgjithshëm nr.9 (2006), Komiteti i Gjenezës për të Drejtat e Fëmijëve, “Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara”, CRC/C/GC/9, 27.2.2007.

² <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2012/06/21/69>, L.44/2023, datë 15.06.2023

³ Miratuar me VKM nr.621, datë 22.10.2021

burimore për gjithë rajonin, duke marrë për bazë modele tashmë të pilotuara në disa zona të vendit.

A1.3.4. Pajisja e shkollave me mjete dhe programe teknologjike për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara. Disa nga programet teknologjike dhe mjetet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara janë: programe kompjuterike të ndryshme për fëmijët me vështirësi në shikim, dëgjim, vështirësi në të folur; makina llogaritëse për fëmijët që vuajnë nga diskalkulia; libra audio; monitor/ekran me prekje; set me puzzle/ngjyra/lodra/fletore; libra me figura; i-pad-e; pecc (komunikim nëpërmjet figurave), etj.

A1.3.5. Përmirësimi i aksesueshmërisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara në çdo shkollë dhe në të gjitha mjediset e shkollës.

A1.6.1. Investime për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore. Kjo infrastrukturë do të përshtatet për aksesin e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike, por edhe sa i takon aspekteve të higjienës, duke respektuar nevojat e veçanta të vajzave dhe djemve, si dhe aspekteve të sigurisë”.

1. Në mënyrë të përmbledhur objektivat e inspektimit janë si vijon:

- kontrolli i performancës në shkollat speciale, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit dhe procedurave që ndjekin këto institucione;
- vlerësimi i cilësisë së punës së personelit të shkollave speciale;
- vlerësimi i mjediseve dhe kushteve të shkollave speciale;
- verifikimin social-psikologjik-shëndetësor i çdo nxënësi që edukohet në shkollat speciale;
- respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar, në zbatim të legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar në fuqi.

2. Metodologjia e inspektimit

Metodologjia e inspektimit përmban:

- zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesin, punonjësit socialë të këtij institucioni të përkujdesit publik rezidencial dhe përfituesit e shërbimeve të institucionit, informacion i cili është hedhur në një formular standard për këto lloj inspektimesh.
- monitorimin dhe inspektimin në vend të kushteve materiale në të cilat jetojnë fëmijët, ku përfshihen ambientet e përbashkëta, tualetet,

- ushqimi, kuzhina, lavanteria, higjiena, lagështira, bombolat kundër zjarrit, ambientet e jashtme, etj.
- verifikimin e përputhshmërisë së gjendjes në vend me standardet e parashikuara në kuadrin rregullator.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i AP-së ka kryer bisedën përmbyllëse me drejtuesin e shkollës speciale dhe personelin, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit dhe u lanë rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuara në fund të raportit.

3. Organizimi dhe funksionimi i Shkollës Speciale “Zëra Jete”

a. Profili i Shkollës Speciale “Zëra Jete”

Në godinën e shkollës speciale “Zëra jete” është mbajtur “Kongresi i Elbasanit” dhe është hapur shkolla e parë e mesme shqipe kombëtare, Shkolla Normale e Elbasanit.

Në vitin 1983, godina ishte e dedikuar për shkollën 8-vjeçare “Thoma Kalefi”, e cila filloi edukimin special për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke hapur një klase pranë këtij institucioni arsimor. Në vitin 1998, me kërkesë të drejtorisë së shkollës dhe stafit pedagogjik dhe me miratimin e Këshillit të Rrethit, ky institucion arsimor merr emrin shkolla speciale “Zëra jete”, duke ofruar edukim për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Shkolla speciale “Zëra Jete” është institucion arsimor që ofron shërbim në fushën e arsimimit, edukimit, mirërritjes dhe kulturës shëndetësore për nxënës me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike⁴.

Në këtë institucion arsimor zhvillohet arsimi fillor dhe i mesëm i ulët që përbëjnë arsimin bazë, i cili zgjat 9 vjet dhe është i detyrueshëm⁵. Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët janë pjesë e arsimit parauniversitar. Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP)

⁴ Bazuar në pikën 5, të nenit 64, i ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar parashikon se “Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit e komisionin, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara.”

⁵ Neni 22 i ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

është njësi zbatuese e arsimit parauniversitar, ku nëpërmjet strukturave të saj të varësisë (Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve arsimore) menaxhojnë sistemin e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndër të tjera: monitorimin, vlerësimin dhe inspektimin; planifikimin e buxhetit të shkollave; mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore; zbatimin e kurrikulës dhe standardeve; ofrimin e asistencës teknike në shkolla, punësimin e mësuesve dhe bashkërendimin me autoritetet vendore.

Në këtë kuptim, shkolla speciale “Zëra Jete” është në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Ndërsa, bazuar në nenin 23, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndërtimi, rindërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i shkollave dhe godinave është në kompetencë të plotë të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, Bashkisë Elbasan.

Mosha e fëmijëve që zhvillojnë procesin e edukimit në këtë institucion arsimor janë nga mosha 6 -19 vjeç.⁶

Veprimtaria edukative mësimore mbështetet në mundësitë që kanë fëmijët me AK, gjë që pasqyrohet në planet mësimore dhe në veçanti në planet individuale për nxënësit që paraqesin më shumë vështirësi⁷. Shkolla është e hapur për të krijuar mundësi integrimi për fëmijët e saj në komunitet.

b. Numri i nxënësve me aftësi të kufizuar në shkollën speciale “Zëra Jete”

Numri i nxënësve për vitin shkollor 2023-2024 nga klasa e I-IX është 53 nxënës nga të cilët 11 femra dhe 42 meshkuj. Konkretisht:

KLASA	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	
<i>Paralele</i>	1	1	1	1	1	1	1	1	1	
<i>Nr. i nxënësve</i>	4	5	6	4	6	6	8	6	7	<i>53 nxënës</i>
<i>Femra</i>		2	5			1	4	1	1	<i>11 (femra)</i>

⁶ Bazuar në pikën 1, të nenit 84 të urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Rebulikën e Shqipërisë” (urdhëri nr.31/2020)

⁷ Bazuar në pikën 5, të nenit 81 të urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Rebulikën e Shqipërisë” (urdhëri nr.31/2020)

Meshkuj	4	3	1	4	6	5	4	5	6	42 (meshkuj)
---------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	-----------------

Vlerësimi i nxënësve bazuar në aftësinë e kufizuar është si vijon:

- klasa e parë ka 4 fëmijë gjithsej nga ku një është me multidiagnozë, 1 me autizëm, 1 prapambetje mendore;
- klasa e dytë ka gjithsej 5 fëmijë, nga ku 1 është me multidiagnoza, 1 me çrreg. të spektrit autik, 1 çrreg. të të folurit, 2 me prapambetje mendore;
- klasa e tretë ka 6 nxënës nga ku 2 me autizëm, 2 me multidiagnoza, 2 me prapambetje mendore.
- klasa e katërt ka 5 nxënës, nga ku 2 me multidiagnozë, 1 sindromën doën, 1 me prapambetje mendore dhe 1 mendore dhe fizike;
- klasa e pestë ka 6 nxënës nga ku 2 me multidiagnozë, 1 suspekt gjenetik encephalopathi, 1 prapambetje mendore dhe 1 me prapambetje mendore dhe fizike;
- klasa e gjashtë ka 6 nxënës, nga ku 2 me multidiagnoza, 3 me autizem dhe 1 me sindromën doën;
- klasa e shtatë ka 8 nxënës, nga ku 3 janë me çrreg. të spektrit autizem, 2 me multidiagnoza, 3 me prapambetje mendore;
- klasa e tetë ka 8 nxënës nga ku 6 nxënës me autizëm dhe 2 me multidiagnoza;
- klasa e nëntë ka 7 nxënës nga ku 1 me sindromën doën, 3 me autizëm, 2 me shumë diagnoza, 1 me probleme mendore dhe fizike.

Nga intervistat e realizuara me drejtuesin dhe stafin e këtij institucion arsimor, AP-ja u informua se kushtet social-ekonomik të pjesës më të madhe të familjeve të nxënësve të kësaj shkolle janë të vështira si rezultat i papunësisë dhe problemeve sociale të ndryshme. Një pjesë e mirë e tyre trajtohen me ndihmë ekonomike, ndërsa disa familje të tjera kanë probleme strehimi. Këtë vit dy familje u trajtuan me banesa sociale.

c. Stafi i Shkollës Speciale “Zëra Jete”

Struktura organike e institucionit përbëhet nga 27 punonjës nga të cilët 24 janë staf pedagogjik⁸: 1 është drejtuesi i shkollës, 1 është nëndrejtori, 6 mësues me arsim special (“bachelor” plus master arsim special), 8 mësues (“bachelor” mësusi dhe master shkecor psikologji), 5 mësues me master

⁸ Struktura organike miratohet nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Elbasan

profesional (bachelor mësuesi, degë të ndryshme histori, gjeografi, cikli i ulët plus master profesional), 4 mësues kanë përfunduar studimet me sistemin e arsimit të lartë 4-vjeçar ndërsa 1 është psikologe klinike, 1 kuzhinier, 1 ndihmëskuzhinier dhe 1 sanitar. Stafi ndihmës është emëruar dhe paguhet nga Bashkia Elbasan.

Në vlerësim të dosjeve të stafit pedagogjik rezultoi se edukimi dhe arsimimi i stafit është në përputhje me pikën 1, të nenit 84 të urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” (urdhëri nr.31/2020)⁹.

Grupi inspektues konstatoi se në kundërshtim me pikën 1, të nenit 84 të urdhërit nr.31/2020, në këtë institucion mungojnë punonjësit e specializuar për aftësinë e kufizuar si terapistë, logopedistë, fiziterapistë etj. Nga intervista e realizuar me drejtuesin e këtij institucioni edukimi këto lloj shërbimesh ofrohen bazuar në marreveshjet e bashkëpunimit që shkolla ka nënshkruar me organizatat jo-qeveritare që ofrojnë shërbime sociale për fëmijët me aftësi të kufizuar të tilla si, Qendra e Autizmit, që mbështetet nga buxheti i shtetit, Qendra Shqiptare për Zhvillim, “Future for you” etj. AP-ja vlerëson se organika e institucionit duhet të jetë në përputhje me urdhërin e sipërcituar.

d. Mjediset strukturore të Shkollës Speciale “Zëra Jete”

Godina në të cilën ushtron veprimtarinë shkolla speciale 9-vjeçare “Zëra Jete” është godinë historike, bazuar në informacionin e sipërcituar dhe është në pronësi të kishës ortodokse, e cila ushtron dhe veprimtari humane fetare dhe nuk ka sjellë probleme në ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni edukimi. Por, duke qenë një godinë historike (Shkolla Normale e Elbasanit) nuk lejohet asnjë ndërhyrje infrastrukturore, çka nuk ndihmon në plotësimin e nevojave të veçanta që duhet të ketë kjo shkollë.

Godina, ku shkolla ushtron veprimtarinë e saj është një ndërtesë dy katëshe. Në katin e parë zhvillon procesin mësimor klasa e VIII dhe IX në një mjedis të përbashkët me menci në të cilin është krijuar dhe një mjedis si sallë për mësuesit e ndarë me pllaka gipsi. Në këtë kat ndodhet kuzhina dhe lavaxhëria, një magazinë ushqimore, zyra e shërbimit psiko-social dhe një

⁹ “...Mësuesit e shkollave të specializuara janë të diplomuar në arsim special...”

mjedis ku janë të vendosura mjetet didaktike dhe sportive me të cilat punojnë mësuesit. Gjithashtu, në këtë kat ndodhet dhe një tualet që nuk është në përputhje me standardet për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ndërsa në katin e dytë ndodhet drejtoria e shkollës, e cila shërben dhe si bibliotekë dhe 7 klasa (nga klasa e parë deri në klasën e shtatë, nga një klasë për çdo cikël) të cilat kanë të gjitha mjetet mësimore të përshtatshme me nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara, të siguruar nga donatorë të ndryshëm si World Vision etj. Në këtë kat ndodhet dhe një tualet i cili nuk plotëson standardet për fëmijët me aftësi të kufizuara. Të gjitha mjediset janë të pajisura me mjetet përkatëse dhe në kuzhinë janë të gjitha pajisjet elektroshtëpiake. Dyert dhe dritaret janë vendosur të reja me mbështetjen financiare të znj. Elia Zaharia dhe mjediset janë të pastërta.

Sigurimi i sistemit të ngrohjes dhe freskimit në të gjitha mjediset e institucionit arsimor në periudhën e dimrit realizohet me soba me dru, pasi është një ndërtesë e vjetër dhe është shumë ftohtë. Gjithashtu, duke qënë ndërtesë historike nuk mund të kryejnë ndërhyrje infrastrukturore për të vendosur kondicioneret, dimri është shumë i vështirë për t'u përballuar. Institucioni është i pajisur me 2 bombola kundër zjarrit dhe stafi është trajnuar për të reaguar në ndonjë rast emergjent.

Vendodhja e këtij institucioni arsimor është në lagjen “Kala” në të njëjtin oborr me godinën e kishës ortodokse “Shën Maria”. Mjediset përreth shkollës janë të kufizuara, duke mos mundësuar pasjen e një palestere apo kend lojrash për të zhvilluar aktivitete okupacionale për nxënësit me aftësi të kufizuara. Në katin e parë me mbështetjen e donatorëve është një serë lulesh ku nxënësit dhe mësuesit kujdesen për to duke bërë të mundur edhe zhvillimin e terapisë për ta.

Bazuar në intervistat e realizuara, AP-ja konstatoi se drejtuesi i institucionit dhe stafi pedagogjik kishin informacion dhe njohuri të kuadrit ligjor për aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjediset e brendshme të institucionit të edukimit. Pengesa e vetme për aplikimin e standardeve të aksesueshmërisë në mjediset e institucionit e lidhet me godinën, e cila është historike dhe nuk lejohet të kryhet në të asnjë ndërhyrje infrastukturore.

Nga monitorimi i mjediseve të këtij institucioni, AP-ja konstatoi se mjediset e shkollës janë të mira, të pastra, por sipërfaqet e klasave janë të vogla. Në këtë institucion mungon aksesueshmëria për fëmijët me aftësi të kufizuara, palestra, kabinetet e terapisë dhe biblioteka si mjedis i veçantë. Këto

elemente nuk plotësojnë kushtet mësimore për zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me standardet e mëposhtme:

- aksesin e lehtë nga nxënësit me aftësi të kufizuar dhe sigurimin e gjithë lehtësirave të nevojshme për mundësimin e aksesit në mjediset e shkollës nga nxënësit me aftësi të kufizuar¹⁰;
- sigurinë e nxënësve pasi çdo shkollë duhet të përmbushë elemente për standardin e sigurisë nga zjarri apo tërmetet, dhe duhet të kenë dalje/shkallët e emergjences.
- mjedise të përshtatshme për kurikulat mësimore të miratuara nga MAS-i, kabinetet terapeutike, palestra, salla IT, salla muzike, ambiente sportive etj., në bazë të kurikulave.
- shkolla tërheqëse dhe kreative pasi përveç elementëve të cilësisë dhe shkollat duhet të jenë tërheqëse për mundësimin në këtë mënyrë ambiente më stimuluese dhe shlodhëse, që ndihmojnë në nxitjen e kreativitetit të nxënësve dhe rritjen e interesit të tyre gjatë procesit të nxënies¹¹.

e. Funksionet dhe veprimtaria e shkollës speciale “Zëra Jete”

Funksionimi i brendshëm dhe organizimi i këtij institucioni arsimor realizohet në përputhje me rregulloren së brendshme të vitit shkollor 2023-2024, të miratuar nga drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Elbasan (ZVA), drejtuesi i shkollës speciale “Zëra Jete” dhe Kryetari i Bordit të Prindërve¹². Kjo rregullore është në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të arsimit parauniversitar¹³. Në përmbajtje rregullorja përfshin veprimtarinë mësimore- edukative për 5 ditët e javës, duke filluar nga orari, koha e qendrimit, përgjegjësit për zbatimin e detyrave ditore, planet mësimore, të drejtat dhe detyrat e stafit pedagogjik, të prindërve, të nxënësve, detyrat e stafit mbështetës (kuzhinier, ndihmëskuzhinier, sanitar, shofer), masat orientuese për menaxhimin e rasteve me agresivitet të lartë

¹⁰ Vendimi nr.1503 datë 19.11.2008 rregullorja “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”

¹¹ Vendim nr. 319, datë 12.4.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave”

¹² Bazuar në pikën 4, të kreu XXV të të urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”

¹³ Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë , ligji nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” etj

në shkollë, Komisioni i Etikës dhe Sjelljes në institucionin arsimor, rregullat për sigurinë dhe shërbimin e rojeve, kurrikula, veprimtaria pas orëve mësimore, detyrat dhe funksioni i shërbimit psiko-social, biblioteka e shkollës etj.

Nga kontrolli i dokumentacioneve, në zbatim të akteve nënligjore të arsimit parauniversitar, grupi i inspektimit verifikoi dokumentet si vijon:

- planin afatmesëm 2024-2028 të shkollës special “Zerat e Jetës” miratuar nga drejtori i ZVA-së, drejtuesi i shkollës special “Zëra Jete” dhe Kryetari i Bordit të Prindërve¹⁴. Plani është në përputhje me planin afatmesëm të ZVA-së Elbasan mbështetur në strategjinë e arsimit parauniversitar dhe planit të veprimit për zbatimin e saj¹⁵ fokusuar në rubrika si misioni; vizioni; analiza e gjëndjes; përparësitë; veprimtaritë kryesore për arritjen e përparësive; tregusit e arritjeve dhe buxheti i përafërt¹⁶;
- planin vjetor 2023-2024 që është bazuar në planin afatmesëm 2021-2024 të shkollës special “Zerat e Jetës” dhe në arritjet e një viti të mëparshëm, i miratuar nga drejtori i ZVA-së, drejtuesi i shkollës speciale “Zëra Jete” dhe Kryetari i Bordit të Prindërve. Rubrikat e përfshira në këtë plan janë procedurat e hartimit të planit, analiza e gjëndjes, synimi, objektivat, veprimtaritë për vëzhgimin e zbatimit të planit¹⁷;
- planet dhe raportet e aktiviteteve të shërbimit psiko-social për vitin shkollor 2023-2024, miratuar nga drejtuesi i institucionit. Aktivitetet e përfshira në këtë plan përfshijnë zhvillimin e trajnimeve për zhvillimin e brendshëm profesional të trupës arsimore, prindërve dhe nxënësve si dhe informimin nëpërmjet bisedave e leksioneve me punonjësit e këtij institucioni arsimor për zhvillimet moshore tipike të nxënësve dhe problemet që ata paraqesin bazuar në nevojat e nxënësve. AP-ja vlerëson punën e kryer nga psikologjia klinike e këtij institucioni. Një ndër aktivitetet e realizuara është aktiviteti vlerësues “*burnout*” për stafin pedagogjik. Qëllimi i këtij aktiviteti është vlerësimi i shkallës së konsumimit profesional në punë përmes matjes së nivelit të ankthit dhe stresit të stafit. Kjo, bazuar në

¹⁴Bazuar në nenin 49 të urdhëri nr.31/2020

¹⁵ vendim nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”

¹⁶ Bazuar në nenin 50 të urdhëri nr.31/2020

¹⁷ Bazuar në nenin 51 të urdhëri nr.31/2020

vështirësinë e punës së stafit pedagogjik me fëmijët me aftësi të kufizuara.

- aplikimin zyrtar për riorganizimin e shkollës speciale special “Zërat e Jetës” në qendër burimore drejtuar MAS-it¹⁸. Nga kontrolli i dokumentacionit zyrtar grupi inspektues i AP-së konstatoi se MAS-i e ka skualifikuar projekt propozimin e këtij institucioni arsimor pasi nuk plotësojnë kushtet infrastrukturore sipas kritereve të përcaktuara në Vendimin nr.148, datë 13.03.2024 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen e riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre”. Bazuar në këtë përgjigje zyrtare të MAS-it, shkolla speciale “Zërat e Jetës” ka kërkuar zyrtarisht me shkresën nr.98 prot., datën 24.04.2024 nga Bashkia Elbasan transferimin e shkollës në një godinë tjetër për të bërë të mundur plotësimin e standardeve të miratura nga MAS-i, por ende ky institucion arsimor nuk dispononte një përgjigje zyrtare.

Praktika e sipërcituar bazohet në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026¹⁹ ku parashikohet ndër të tjera, si objektivi edhe: “*A1.3.3. Fuqizimi i shkollave speciale dhe kthimi i tyre në qendra burimore për aftësinë e kufizuar*, i cituar më sipër në faqen 3.

Shërbimet që ofron shkolla trajtohen në vijim:

Procesi i edukimit, shkolla speciale “Zëra Jete” trajton nxënës me aftësi të kufizuara mendore, fizike, gjuhësore dhe multidiagnoza. Nxënësit që frekuentojnë këtë institucion edukimi janë të pajisur me raportin mjekoligjor që vërteton aftësinë e kufizuar mendore. Regjistrimi i fëmijëve në këtë shkollë rekomandohet nga Komisioni për Nxënësit me Aftësi të Kufizuar (KNAK) të ngritur pranë ZVA-së Elbasan, pasi kanë vlerësuar se ndjekja e një shkolle të zakonshme nuk zhvillon sa duhet fëmijën me AK²⁰. Komisioni i institucionit arsimor të zakonshëm i ngritur pranë kësaj shkolle udhëzon mësuesit për hartimin e Planit Edukativ Individual (PEI) dhe miraton këtë plan²¹. Bazuar në vlerësimin e KNAK-së, mbështetur në klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit të aftësisë së kufizuar dhe

¹⁸ Bazuar në Vendimin nr.148, datë 13.03.2024 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen e riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre”

¹⁹ Miratuar me Vendimin nr.621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave

²⁰ Bazuar në pikën 10, të nenit 80 të urdherit 31/2020

²¹ Bazuar në pikën 10, të nenit 80 të urdherit 31/2020

shëndetit, shkolla speciale “Zëra Jete” trajton nxënës me prapambetje të mesme ose të moderuar mendore (PMM), nxënës me prapambetje të rëndë mendore (PRM), nxënës me Sindromë Down, nxënës me çrregullim të spektrit autik, me çrregullime të sjelljes dhe qëndrime emocionale të shoqëruara dhe me probleme të mprehta sociale.

Këta nxënës marrin njohuri nga programet e arsimit të ciklit fillor, nga klasa I-IX, me program të reduktuar dhe punojnë me plane edukative individuale (PEI). Tekstet shkollore të cilat përdoren për zhvillimin e procesit mësimor të këtyre nxënësve janë të bazuara në kurrikulën bazë të miratuar nga MAS-i dhe nuk kanë anjë ndryshim nga tekset e shkollave normale.

Nga intervistat e realizuara nga grupi i inspektimit të AP-së me stafin pedagogjik dhe atë të shërbimit psiko-social u informua se këto tekste nuk janë të përshtashme për nxënësit me AK. PEI-i është një qasje e re dhe produktive që hartohet në një draft-format të standardizuar, ende të pamiratuar, besuar në eksperiencën e punës së stafit pedagogjik për këtë kategori.

Njohuritë mësimore të këtyre nxënësve fillojnë së pari me njohuritë fillestare për aftësimin e tyre praktik për jetën. Referuar specifikës së këtij institucioni janë të domosdoshme zhvillimi i mësimit lojë, përdorimi i mjeteve mësimore funksionale, vënia e nxënësve në punë të llojeve sa më të larmishme, konkretizimi i orës së mësimit dhe aktivizimi maksimal i mundshëm i nxënësve.

Procesi i të kuptuarit tek këta fëmijë lidhet ngushtë me veprimet e kryera mbi objektet konkret. Këto mjete mësimore marrin vlerë didaktike kur janë funksionale, të thjeshta, të larmishme, të shumëllojshme, të përshtatura sipas moshës së fëmijëve, me një fushë të gjerë përdorimi, kur nxisin fantazinë, e, mbi të gjitha, kur nxisin efektin tërheqës tek fëmijët për ta konkretizuar sa më qartë orën e mësimit. Bazuar në këtë qasje mjetet mësimore të cilat përdornin mësuesit në klasat e tyre janë tabela të ndryshme, shkronja të alfabetit, etiketa rrokjesh dhe fjalësh, tabela plastike në të cilat fëmijët mund të shkruajnë, të vizatojnë e të fshijnë, lojëra të ndryshme me “*puzzle*” me figura për t’i riformuar.

Ushqimi: bazuar në kontrollin e dokumentacioneve (menuja javore e ushqimit) dhe monitorimin e kuzhinës, AP-ja konstatoi se menuja është

standarde e miratuar nga Bashkia Elbasan sipas kuotës ditore në masën 150 lekë në ditë²².

Përmirësimet e fundit ligjore për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike janë realizuar me Vendimin nr. 511, datë 27.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar. AP-ja konstaton se masa e kuotës financiare të ushqimit në mensa e konvikte është përcaktuar me vendim qeverie dhe duhet të indeksohet çdo vit në varësi të inflacionit për të realizuar të drejtën për ushqim të shëndetshëm, si pjesë e të drejtave njerëzore bazë të njeriut theksuar në Konferencën Ndërkombëtare të Ushqyerjes, në vitin 1992, dhe në Samitin Botëror të Ushqimit në 1996, bazuar në ligjin nr 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

Fëmijët frekuentojnë shkollën nga ora 08.00-13.45. Brenda këtij orari nxënësit konsumojnë 2 vakte ushqimi (mëngjes-drekë), mëngjesi shërbehet nga ora 8.45-09.15 dhe dreka shërbehet nga ora 12.15-12.30.

Kampionët ushqimorë janë të ruajtura në mjedise të përshtatshme dhe sipas vakteve. Kuzhinierja është e pajisur me librezë shëndetësore.

Gjatë intervistës së realizuar me stafin, grupi inspektues i AP-së u njoh me faktin menuja është standard janë të njëjtat ushqime çdo javë nga e hëna në të premte dhe nuk ndryshon nga java në javë apo nga stinët e vitit. Kjo nuk varet nga drejtuesit e shkollës, pasi furnizimi me ushqime realizohet cdo ditë nga furnitorët e bashkisë që furnizojnë dhe kopshtet/çerdhet të cilët janë në juridiksionin e Bashkisë Elbasan.

AP-ja konstaton se menuja nuk përmban shumëllojshmëri ushqimesh në varësi të nevojave bazë të aftësisë së kufizuar të fëmijëve, moshës dhe stinëve.

²²Vendimi nr.511 datë 27.07,2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” të ndryshuar

Transporti i fëmijëve: Nxënësit e shkollës speciale “Zëra Jete” janë nga bashkia Elbasan dhe rrethinat e saj. Bazuar në aftësinë e tyre të kufizuar dhe vendodhjes gjeografike të banesës transporti i disa fëmijëve realizohet me një furgon të siguruar nga Bashkia Elbasan. Mjeti i transportit është gjashtë plus dy, ka vende të kufizuara dhe nuk mundëson dot prezencën e një mësuesi për shoqërimin e tyre. Nga intervista e realizuar me drejtuesen e institucionin, u informuam se shoferi është trajnuar për të garantuar sigurinë e fëmijëve gjatë transportimit të tyre. Gjithashtu, nga intervista me drejtuesen e shkollës dhe monitorimi fizik i kryer nga grupi i inspektimit mjeti i transportit nuk është sipas standardeve të miratura për aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Bashkia Elbasan kishte siguruar një mjet transporti me 15 vende me të gjitha elementët përbërës që plotësonin standardet për aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuar, sidomos dhe për fëmijët me aftësi të kufizuar fizike (karroca), por rrugicat e kalasë së Elbasanit, ku ka vendodhjen shkolla, janë të ngushta dhe nuk mund të sigurohej hyrja e këtij mjeti transporti. Në këto kushte, ky mjet u zvendësua me mjetin aktual që kishte shkolla. Asnjë nga nxënësit që përdorin këtë mjet transporti nuk është me aftësi të kufizuara fizike. Një nxënës që është me aftësi të kufizuara me vështirësi në lëvizje shoqërohet nga prindi për frekuentimin e shkollës dhe nga mësuesit gjatë lëvizjes së tij në mjediset e shkollës.

Ky vlerësim është pjesë e punës, tregues për ndërtimin e punës edukative individuale me këto familje dhe fëmijët e tyre për hartimin e PEI-it dhe trajnimeve që duhet të organizojnë me prindërit.

4. Rekomandime të institucioneve/organizmave ndërkombëtare

Gjatë veprimtarisë së tij, Avokati i Popullit u ka kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve me aftësi të kufizuar. Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), si dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK). Kjo e fundit parashtron tetë parime të përgjithshme, duke përfshirë “respektin për aftësitë në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre”. Konventa u kërkon shteteve të nisin një ndryshim kulturor, duke theksuar barazinë, përfshirjen dhe mosdiskriminimin për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, duke vënë në dukje zhvillimet pozitive që kanë ndodhur në kuadrin ligjor dhe rregullator në avancimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ka sjellë në vëmendje Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 9 (2006) mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe i ka rekomanduar, së fundmi, shtetit shqiptar²³:

(a) Zbatimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut ndaj aftësisë së kufizuar dhe *rritjen e vëmendjes politike dhe investimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara*;

(d) Të krijojë një politikë për *sigurimin e pajisjeve dhe teknologjisë ndihmëse për të lehtësuar aksesin dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara*;

(e) Të sigurojë *aksesin në shkolla, qendra të kujdesit shëndetësor dhe hapësirat publike, ndërtesa, shërbime dhe informacion për fëmijët me aftësi të kufizuara*;

(f) Të *forcojë kapacitetin e profesionistëve për të punuar dhe mbështetur familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara*.

Në mbështetje të objektivave 4.1–4.7 dhe 4.a të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Komiteti i ka rekomanduar gjithashtu, ndër të tjera, shtetit shqiptar ndër të cilat citojmë²⁴:

(b) Sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës në mjediset e edukimit të fëmijërisë së hershme dhe shkollat e zakonshme për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara duke përshtatur kurrikulat dhe trajnimin dhe duke caktuar mësues dhe profesionistë të specializuar në klasa të integruara, në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë të marrin mbështetje të individualizuar dhe vëmendjen e duhur, duke u ofruar transportin dhe sigurimin e akomodimit të arsyeshëm në shkolla;.....

(i) Të sigurojë që aktivitetet e lira, sportive dhe artistike dhe hapësirat e gjelbra të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme në të gjitha bashkitë, veçanërisht për vajzat, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët që u përkasin grupeve minoritare dhe fëmijët që u përkasin grupeve të tjera të marginalizuara²⁵.

²³Pika 32 e Konkluzioneve përfundimtare mbi raportet 5 dhe 6 të Shqipërisë, shtator 2023

²⁴ Pika 39 e Konkluzioneve të Komitetit të KDF

²⁵ Konkluzionet përmbyllëse pas raportit të 5-të dhe të 6-të të Shqipërisë për Konventën e të Drejtave të Fëmijës- Concluding observations on the combined fifth and sixth periodic reports of Albania, 17 October 2023, CRC/C/ALB/CO/5-

Duke garantuar të drejtën e tyre për t'u arsimuar, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës, në zbatim të neneve 18 e 28, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, si dhe të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, kërkohet nga institucionet përgjegjëse ndërmarrja e hapave dhe e veprimeve konkrete në kuadër të arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qendrushëm (OQZH 4), për arsimin në vendin tonë.

Bazuar në gjetjet e mësipërme të inspektimit dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin e të drejtave të fëmijëve në interesin më të lartë të tyre dhe, konkretisht, për realizimin e një procesi arsimimi cilësor e gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.02.1999,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për miratimin e formatit të standartizuar të Planit Edukativ Individual (PEI) brenda vitit të ri shkollor 2024-2025.
- Marrjen e masave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për indeksimin kuotës financiare të ushqimit në mensa e konvikte për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore vit pas viti në përputhje me ndryshimin e normave të inflacionit.
- Marrjen e masave nga Bashkia Elbasan për transferimin e shkollës speciale “Zëra Jete” në një godinë tjetër e cila të përmbushë të gjitha standardet për aksesueshmëri dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe për të mundësuar riorganizimin e këtij institucioni në qendër burimore për këtë kategori fëmijësh mundësisht brenda dy viteve.
- Marrjen e masave nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për realizimin e një studimi me qëllim përshtatjen e kurrikulës mësimore për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet e edukimit special.

- Marrjen e masave nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar për plotësimin e pozicioneve në organikën e këtij institucioni edukimi me mësues të specializuar, konkretisht me logoped, fizioterapist, ortofonist bazuar në pikën 5, të nenit 81 të urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” brenda vitit të ri shkollor 2024-2025.
- Marrjen e masave nga Bashkia Elbasan në bashkëpunim me shkollën speciale “Zëra Jete” për ndryshimin dhe krijimin e një menuje të specifikuar me shumëllojshmëri ushqimesh në varësi të nevojave bazë të aftësisë së kufizuar të fëmijëve, moshës dhe stinëve brenda vitit të ri shkollor 2024-2025.
- Marrjen e masave nga Bashkia Elbasan për vendosjen e një mjeti transporti që përmbush standardet e transportit dhe aksesueshmërisë për fëmijët me aftësi të kufizuar, pas transferimit të shkollës speciale “Zëra Jete” në një godinë tjetër.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave AP-ja u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

K O M I S I O N E R

OLTA ALIAJ